



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE  
QËNDRA FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr.      prot

Tiranë me      .2024

**Lënda:** Njoftim për vend të lire pune

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lire të punës për pozicionin instruktor të praktikës profesionale me kohë të pjesshme:

**Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Aftësi Dixhitale -----1 Person**

**Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Start Smart -----1 Person**

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për si vijon:**

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

- të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- aftësi të tjera nëse kërkohen.

**2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të nërfshihet:

- a. letërmotivimin për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV në);
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën;
- e. librezën e punës;
- f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- k. të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFPsë, brenda datës ..06.11.2024

Duke ju falenderuar për mirekuptimin

**Drejtori**

Valbona Moxha

